



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:206840
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05641918

PA1.nr.1090/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ilmije Rexhepi Beqiri si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit XH.J, për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit XH.J, av. F.B, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.169/2023 të dt.14.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 26.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit XH.J, av. F.B, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.169/2023 të dt.14.08.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë- Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, me aktgjykimin P.nr.169/2023 të dt.14.08.2023, të akuzuarin XH.J, e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1500.00 € (njëmijë e pesqindë /Euro), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë. Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë pas afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do t'i llogaritet 1(një) ditë burg. Konform nenit 366 të KPRK-së, të akuzuarit

gjithashtu i konfiskohet një pushkë automatike A47, prodhim kinez, me numër serik:309764221, me një karikator dhe 21 fishek, si mjete të kryerjes së veprës penale. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit XH.J, av. F.B, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar lidhur me vendimin mbi dënimin në favor të akuzuarit, si dhe i njëjti të lirohet i pandehuri nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale në tërësi, konform nenin 452 par.4 të KPPRK-së, ngase pagesa do ta rrezikonte gjendjen materiale të pandehurit dhe familjes së tij.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1126/2023 të datës 07.09.2023, ka propozuar që të refuzohet ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit ashtu që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është atakuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarës e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Mbrojtësi i akuzuarit XH.J, av. F.B, e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal dhe lirimin nga pagesa e shpenzimeve të procedurës me pretendimet se gjykata e gjykata e shkallës së parë gjate vendosjes lidhur me sanksionin penal dhe shpenzimet e procedurës penale nuk ka bere vlerësimin e drejt te rrethanave lehtësues qe i kanë paraprirë marrjes se këtij aktgjykimi, dënimi i shqiptuar është i larte për faktin se i akuzuari qe nga fillimi i procedurës si dhe në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar përgjegjësin e tij për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe dënimin e shqiptuar është tejet i lart dhe nuk është në proporcion me rrethanat lehtësues, kjo pasi që gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit dhe llojit të dënimit nuk ka marrë parasysh rrethanat posaçërisht lehtësuese, si sjellja e të akuzuarit në nivelin e duhur gjatë gjithë procedurës, bashkëpunimin e tij me organet e drejtësisë, rrethanat personale të tij, se faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, i njëjti është i pa dënuar apo hetuar, i gjendjes së dobët ekonomike, prind i tre fëmijëve. Andaj, mbi këtë bazë dhe këto arsye, konsiderojmë se ky dënim nuk është në përputhje me qëllimin e

tij siç është parashikuar me nenin 41 të KPRK-së i cili qëllim tejkalohet në mënyrë serioze me këtë aktgjykim dhe gjithashtu i njëjti mund të ndikoj negativisht edhe në përkeqësimin e mëtejme të gjendjes ekonomiko-financiare të akuzuarit dhe familjes së tij me asnjë burim tjetër financiarë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të ulët për të akuzuarin. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit në pajtim me dispozitat e nenit 69 të KPK-së, pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh faktin se i akuzuari ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka kërkuar falje, i ka premtuar gjykatës se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk ka gjetur.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit për ti shqiptuar një dënim më të ulët konsideron se janë të pabazuara. Ngase të gjitha këto rrethana, e sidomos duke marrë parasysh faktin se i akuzuari ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka kërkuar falje, i ka premtuar gjykatës se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjeneralë, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet të mbrojtësit të të akuzuarit për shpenzimet e procedurës penale, ngase se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur të akuzuarin e ka obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1090/2023, më datë 26.04.2024

Procesmbajtësja,
Ilmije Rexhepi Beqiri

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Abdullah Ahmeti

Zyhdi Haziri
